



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

Nr. 1556 prot.

Elbasan, më 23.07.2021

VENDIM


Nr. 24 datë 23/07/2021

“PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT
“ALEKSANDËR XHUVANI” NË DISA PROGRAME TË REJA STUDIMI, PËR VITIN
AKADEMIK 2021-2022”

Bazuar në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofuara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 2.7, germa a,b,c, në Statutin e UE-së, neni 9, germa “h”, si dhe në propozimet e njëjste kryesore të UE-së, Senati Akademik i UE-së më datë 23.07.2021.

V E N D O S I :

1. Të miratojë kuotat e pranimit, në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani për programet e reja të studimit, për vitin akademik 2021-2022 (tabela Nr.1 bashkëngjitur këtij vendimi), si më poshtë:
 - a) Bachelor në Studime mjedisore
 - b) Program me karakter profesional në Operator turistik
 - c) Master profesional në Mësues ndihmës
 - d) Master i shkencave në Informatikë ekonomike
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Dr. Skender TOPI

KRYETARI

